

V E N D I M
Nr. 2, datë 31.1.2003

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fehmi Abdiu	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese,
Zija Vuci	Anëtar i “ “
Gjergj Sauli	Anëtar i “ “
Alfred Karamuço	Anëtar i “ “
Kristofor Peçi	Anëtar i “ “
Kujtim Puto	Anëtar i “ “
Sokol Sadushi	Anëtar i “ “
Petrit Plloçi	Anëtar i “ “

me sekretare Arbenka Lalica, më datën 30.1.2003, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura, çështjen nr.172/3 Akti, që i përket:

KËRKUES: GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR DURRËS
SUBJEKTE TË INTERESUARA:

1. KRISANTHI QIRKO, përfaqësuar nga avokat Rustem Syziu.
2. HYSEN, BETIM, ADILE MYSHKETA; LIRI DAKOLI e DHURATA SARAÇI, përfaqësuar nga avokat Rifat Aliu.

OBJEKTI: Shfuqizimi si antikushtetues i ligjit nr.355, datë 21.11.1946 “Mbi shlyerjen e huave që kanë lindur para datës 29 nëntor 1944”.

BAZA LIGJORE: Nenet 131/a e 145/2 të Kushtetutës.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, në vendimin për dërgimin e çështjes Gjykatës Kushtetuese, ka parashtruar ndërmjet të tjerash, këto shkaqe për antikushtetutshmërinë e ligjit të mësipërm:

- Nëpërmjet dispozitave të ligjit nr. 355, datë 21.11.1946 “Mbi shlyerjen e huave që kanë lindur para datës 29 nëntor 1944”, shteti ka ndërhyrë në të drejtën e pronës të personave privatë, të parashikuar në nenin 41 të Kushtetutës.

- Ligji nr. 355, datë 21.11.1946, bie në kundërshtim edhe me parimet kushtetuese të sanksionuara në nenet 3 e 11 të Kushtetutës.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Petrit Plloçi, përfaqësuesit e subjekteve të interesuara dhe shqyrtoi çështjen

V Ë R E N:

Paditësja Krisanthi Qirko ka ngritur padi në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës kundër të paditurve Hysen, Betim e Adile Myshketa, Liri Dakoli, Dhurata Saraçi, me objekt – detyrimin për kthimin e një shume parash.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, ka konstatuar, se detyrimi ndërmjet palëve ka lindur që në vitin 1938 dhe se zgjidhja e konfliktit të mësipërm, bazohet në efektet e ligjit nr. 355, datë 21.11.1946 “Mbi shlyerjen e huave që kanë lindur para datës 29 nëntor 1944”.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, duke çmuar se ligji i mësipërm është në fuqi dhe duke vënë në dyshim kushtetutshmërinë e këtij ligji, në bazë të nenit 145/2 të Kushtetutës, ka pezulluar gjykimin dhe ia ka dërguar çështjen Gjykatës Kushtetuese.

Lidhur me shkaqet e antikushtetutshmërisë së ligjit të kundërshtuar, në vendimin e mësipërm, gjykata e rrethit ka parashtruar se me anën e këtij ligji, në nenin 1 të të cilit parashikohet, se të gjitha

huatë që kanë lindur para datës 29 nëntor 1944 shlyhen krejt, shteti ndërhyt në të drejtat e individit, se nëpërmjet këtij ligji, shteti merr përsipër të ndryshojë pasojat juridike që kanë lindur si rezultat i marrëdhënieve juridike të krijuara ndërmjet palëve të caktuara, pa qenë vetë palë në këto marrëdhënie. Sipas Gjykatës, me anën e ligjit të kundërshtuar, shteti u cenon individëve të drejtën e pronës si një e drejtë themelore. Konkretisht, gjykata ka vlerësuar se ligji i mësipërm bie në kundërshtim me nenet 3, 11 e 41 të Kushtetutës.

Gjykata Kushtetuese, lidhur me pretendimin se ligji i kundërshtuar është në fuqi, nuk mund të bashkohet me opinionin e shprehur nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës.

Në nenin 132 pika 1 të Kushtetutës është parashikuar, se Gjykata Kushtetuese ka vetëm të drejtën e shfuqizimit të akteve që shqyrton. Përveç kësaj, kontrolli kushtetues i ligjeve ose akteve të tjera normative shtrihet vetëm mbi ato burime të të drejtës që aktualisht janë në fuqi. Megjithatë, në disa raste, këtij kontrolli i nënshtrohen edhe norma juridike të shfuqizuara, kur këto, si pjesë e të drejtës pozitive, duhet të zbatohen për rregullimin e pasojave juridike, që zgjasin në kohë dhe janë të lidhura me ekzekutimin periodik ose me afat të detyrimeve juridike civile, që rrjedhin nga marrëdhënie juridike të krijuara në kohën e ligjit të shfuqizuar.

Duke iu referuar çështjes objekt gjykimi dhe duke e parë atë në dritën e dispozitave të lartpërmendura, Gjykata Kushtetuese arrin në përfundimin, se kërkesa e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës është pa objekt, pasi ligji i kundërshtuar prej kësaj gjykate për papajtueshmëri me Kushtetutën ka rënë nga fuqia.

Ligji i mësipërm, i atakuar si antikushtetues, ka pasur për qëllim të shlyejë detyrimet vetëm për një periudhë të caktuar dhe vetëm ato detyrime, që kishin të bënin me kontratat e huave. Me plotësimin e këtij qëllimi ky ligj ka rënë nga fuqia. Përveç kësaj, ky ligj, hyn në kategorinë e ligjeve të posaçme. Për pasojë, duke qenë i tillë, në rastet kur ligji pasardhës është i përgjithshëm, nuk aplikohet rregulli i abrogimit (i shfuqizimit nga ligjvënësi). Këtu bën përjashtim vetëm rasti kur ligjvënësi shpreh një vullnet të kundërt, domethënë, në rastet kur me ligjin e përgjithshëm që nxjerr pas ligjit të posaçëm, ligjvënësi ka për qëllim të eliminojë ose të rregullojë pasojat që ka sjellë ligji i posaçëm, gjë që në rastin në shqyrtim nuk ka ndodhur.

Në këto kushte, Gjykata Kushtetuese, çmon se ligji objekt - kërkesë ka rënë vetvetiu nga fuqia për shkak se e ka realizuar qëllimin e tij. Nga ana tjetër, ky ligj është edhe i pazbatueshëm pasi aktualisht, asnjë pasojë e krijuar prej tij nuk ka mbetur pa u ezauruar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 68 e 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,

V E N D O S I:

- Rrëzimin e kërkesës;
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.